

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale të imta”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
39511100-8, 39512000-4, 39512100-5, 39512500-9.**

VLERA E FONDIT LIMIT:

- Fondi total 5 128 900 (pesë milion e njëqind e njëzetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurrohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasinë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4/b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo

më të madhe se 20 % të vlerës së perlloritur te kontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1 (një) automjet** i përshtatshëm me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, për transportin e produkteve objekt prokurimi, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, në pronësi ose në përdorim sipas kontrates noteriale, të vërtetuar me:

- leje qarkullimi,
 - çertifikate pronësie
 - siguracion (TPL)
 - çertifikatë e kontrollit teknik
- Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

***Argumentim:** Kriteri që OE ofertues duhet të disponojë një automjet i përshatshëm për transportin e mallarve objekt prokurimi, është në funksion të zbatimit të kontratës. Gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues në bazë të grafikut të lëvrimit, do të transportojë me automjetet e veta mallart të kërkuar, në magazinën e DPÇK.*

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur, me çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të, të vlefshme, e lëshuar nga një organ i akredituar, ku objekti i ISO të ketë lidhje me fushën e veprimtarisë objekt prokurimi.

***Argumentim:** Kriteri që OE ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, për tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton. Referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, “SSH ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë ku OE i duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar produkte që plotësojnë kërkesat e AK dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative si dhe ka për qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit dhe të kërkesave të zbatueshme ligjore dhe rregullative”*

2.3.4 Për artikujt e listës së mëposhtme:

_____ Adresa: Rruga “Barrikadave”, KodiPostar 1001, tel.:+355 42222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al_____

| | | | |
|---|----------------------------------|-----|------------------|
| 1 | Çarçaf shtrati i poshtëm (basme) | SET | 1 Raport Analizë |
| 2 | Çarçaf shtrati i sipërm (basme) | | |
| 3 | Këllëf jastëku (basme) | | |
| 4 | Çarçaf i sipërm (fanellate) | SET | 1 Raport Analizë |
| 5 | Çarçaf i poshtëm (fanellate) | | |
| 6 | Këllëf jasteku (fanellate) | | |
| 7 | Jastëk për fëmijë | | 1 Raport Analizë |
| 8 | Batanije për fëmijë | | 1 Raport Analizë |
| 9 | Mbulesa tavoline | | 1 Raport Analizë |

OE duhet të paraqesë:

Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare “Raport Analizë” ku të jenë analizuar të gjithë treguesit teknikë të kërkuar në specifikimet teknike, të kryera nga institucione të akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Raport-testimi i këtyre produkteve nga laboratorit përkatës duhet të lëshohet duke i bashkëngjitur një copë të prerë nga produkti i cili është testuar. Kjo copë lidhet me raportin analizës nëpërmjet vulës së laboratorit.

Copa e përdorur për artikullin mostër, dhe ajo që i bashkëngjitet Raport-Analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Për arsyet e mësipërme analiza, përveç se duhet të paraqitet në SPE, duhet të paraqitet edhe origjinale ditën e paraqitjes së mostrave, **me qëllim që të konstatohet se copa e përdorur për artikullin mostër, dhe ajo që i bashkëngjitet Raport-Analizës është e njëjtë.**

* Për grup artikujt të cilët në specifikimet teknike janë përcaktuar si sete, meqënëse çdo SET është i prodhuar me të njëjtin material, OE duhet të paraqesë vetëm 1 (një) Raport testimi (që i përputhet materialit të përdorur për setin, basëm ose fanellatë).

_____ Adresa: Rruga “Barrikadave”, KodiPostar 1001, tel.:+355 42222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al_____

Argumentim: Kriteri që OE duhet të paraqesë ”Dëshmi për rrezultatet e testimeve zyrtare “Raport Analizë” ku të jenë analizuar të gjithë treguesit teknikë të kërkuar në specifikimet teknike, të kryera nga institucione të akredituara, është vendosur për të vërtetuar që produktet që ofron OE plotësojnë, teknikisht, të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike të AK. Raport-testimi i këtyre produkteve nga laboratorit përkatës duhet të lëshohet duke i bashkëngjitur një copë të prerë nga produkti i cili është testuar. Kjo copë lidhet me raport analizën nëpërmjet vulës së laboratorit. Copa e përdorur për artikullin mostër, dhe ajo që i bashkëngjitet Raport-Analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta. Për arsyet e mësipërme analiza duhet të paraqitet në SPE dhe origjinale ditën e paraqitjes së mostrave, me qëllim që të konstatohet se copa e përdorur për artikullin mostër, dhe ajo që i bashkëngjitet Raport-Analizës është e njëjta.

2.3.5. Për artikullin:

Për artikullin:

”Dyshek krevati për fëmijë”

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :

- **fragmente të katalogut** të prodhuesit për produktin e paraqitur si mostër
- **skedën teknike** të tij
- Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar.

Të dhënat teknike të përcaktuar në katalog dhe në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.

Fragmentet e katalogjeve duhet të specifikojnë qartë mallrat që do të ofrohen dhe prodhuesin të cilit ato i përkasin.

Në rastin kur katalogu ose skeda teknike janë në gjuhë të huaj, ato duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Për këtë artikull OE ofertues duhet të paraqesë:

- **Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë:**
- Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhë” Standard 100 për bebe ose ekuivalente me të.

Argumentim: Duke iu referuar kërkesave përkatëse për specifikimet teknike të artikullit “Dyshekë krevati për fëmijë”, AK ka kërkuar që OE duhet të paraqesë pjesë të katalogut dhe skedën teknike të prodhuesit për këtë produkt. Të dhënat teknike të përcaktuar në katalog dhe në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara. Fragmentet e katalogjeve duhet të specifikojnë qartë mallrat që do të ofrohen dhe prodhuesin të cilit ato i përkasin. Kjo është kërkuar në mënyrë që AK të verifikojë lidhjen midis prodhuesit, përcaktimeve që vetë prodhuesi ka deklaruar në katalogun dhe skedën teknike përkatëse, në raport me artikullin e paraqitur si mostër. Ky verifikim është në funksion të plotësimin të kërkesave që AK ka vendosur për tre pjesët kryesore përbërëse të dyshekut, në specifikimet teknike.

Deklarata e konformitetit të prodhuesit të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, kërkohet për të verifikuar që materiali veshës i dyshekut plotëson kërkesat e përcaktuara në psecifikimet teknike.

Për materialin veshës të dyshekut, i cili ka kontakt të drejtëpërdrejtë me lëkurën e fëmijëve, OE duhet të paraqesë çertifikatën OEKO-TEX “Lista e Bardhë” Standard 100 për bebe ose ekuivalente me të. Duke iu referuar informacioneve të publikuara mbi këtë standard, STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstile të testuara për substanca të dëmshme. Ai përfaqëson besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit. Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, mund të jeni të sigurt se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th., çdo fije, buton dhe aksesori të tjerë, është testuar për substanca të dëmshme dhe se si rrjedhim artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut.

2.3.6. Ditën e hapjes së tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Nje muster te realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per secilin nga artikujt e kerkuar.

Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane DPÇK, Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tirane.

Mostrat duhet te paraqiten per artikujt e mëposhtëm:

| Nr | Emërtimi | Kërkesat e procedurës |
|-----------|----------------------------------|---|
| 1 | Çarçaf shtrati i poshtëm (basme) | 1 (një) copë Mostër Emri i artikullit, Data e zhvillimit të tenderit, Emrin i prodhuesit/ofertuesit, Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik |
| 2 | Çarçaf shtrati i sipërm (basme) | |
| 3 | Këllëf jastëku (basme) | |
| 4 | Çarçaf i sipërm (fanellate) | |
| 5 | Çarçaf i poshtëm (fanellate) | |
| 6 | Këllëf jasteku (fanellate) | |
| 7 | Jastëk për fëmijë | |
| 8 | Batanije për fëmijë | |
| 9 | Mbulesa tavoline | |
| 10 | Dysheke krevati për fëmijë | |

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë të dhënat:

- *Mostër*
- *Emri i artikullit,*
- *Data e zhvillimit të tenderit,*
- *Emrin i prodhuesit/ofertuesit,*
- *Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik.*

Shënim: *Mos paraqitja mostrave të kërkuara, raport analizave orgjinale dhe dokumentacionit shoqërues të kërkuar, në vendin, ditën dhe orën e hapjes së ofertave per te gjithë mallrat objekt prokurimi eshte kusht per skualifikim.*

Argumentim: Kërkesa që OE, ditën e hapjes së duhet të duhet te paraqesë nje muster te realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per secilin nga artikujt e kërkuar, është vendosur në funksion të inspektimit, kontrollit dhe verifikimit për plotësimin e specifikimeve teknike për produktet e ofruara për të cilët duhet të paraqiten edhe dokumentacioni i kërkuar më sipër.

II. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Përgatitja e specifikimeve teknike te artikujve objekt i këtij prokurimi, është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 10498, datë 15.12.20211 “Për tregëtimin dhe mbikqyrjen e produkteve të tregut të produkteve jo-ushqimore”, duke u konsultuar me specialistët përkatës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Departamenti i tekstilit dhe modës, “Katalogut të Standardeve Shqiptare 2019” të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, referuar Klasifikimit Ndërkombëtar për Standardet ISC, faqe 945, Industria Tekstile dhe e Lëkurës” si dhe gjithë informacioneve nga stafi i çerdheve dhe kopshteve për kërkesat për cilësinë e kërkuar si dhe për përcaktimin e parametrave teknikë të cilët duhet të analizohen.

Duke iu referuar materialit të kërkuar, në bashkëpunim me specialistët e fushës në Laboratorin e Tekstilit, në Departamentin e Tekstilit dhe Modës në Universitetin Politeknik të Tiranës, janë përcaktuar parametrat teknikë të materialit të kërkuar për çdo produkt, si peshë specifike për m², lloji i thurjes, qëndrueshmëria në larje, qëndrueshmëria në grisje, ndryshimet e lejuara në dimension pas larjes, loji i materiali përbërës, etj., në mënyrë që produktet të jenë sa më cilësore rezistente dhe të sigurojnë jetëgjatësi maksimale.

Përshkrimi i artikujve në specifikimet teknike është përcaktuar duke patur parasysh specifikat në përdorimin e secilit prej tyre për çerdhet dhe kopshtet për të siguruar cilësinë e kërkuar në raport me natyrën e përdorimit të tyre. Këtu është patur parasysh se artikujt çarçafë, jastëk, batanije dhe dyshekë janë artikuj të cilët do të përdoren në çerdhet dhe kopshtet për fëmijë të grup-moshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Dimensionet, përmasat e çarçafëve dhe dyshekëve janë vendosur në raport me përmasat e krevateve duke krijuar përshtatshmërinë e nevojshme midis çarçafëve, kllëfave të jastëkve, dyshekëve dhe batanijeve.

Dimensionet e mbulesave të tavolinës janë vendosur duke i përshatur ato me përmasat e tavolinave që aktualisht kanë çerdhet dhe kopshtet.

Për hartimin e specifikimeve teknike të dyshekut për fëmijë, Komisioni i ka konceptuar kërkesat për plotësimin e standardeve për tre përberësit kryesorë të dyshekut që janë: Materiali veshës i dyshekut, Struktura e brendshme e dyshekut dhe këllëfi i jashtëm veshës kundra ujit. Kërkesat cilësore për përbërjen e secilit prej tyre i janë referuar OEKO-TEX “Lista e Bardhe” Standard 100 per bebe, i cili garanton që ky produkt është i testuar për substanca të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Për strukturën e brendshme të dyshekut është kërkuar lloji i materialit përbërës shkume poliuretani D21 MECFOAM ose ekuivalente, material i cili është më i përshatshëm për përdorim për fëmijë. Ndërsa për shtresën e jashtme të dyshekut është kërkuar që të jetë rezistente ndaj ujit, i lashem ne lavatrice ne 40°C, rezistent deri ne mbi 200 larje.

Në mënyrë që të verifikohen nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara, është kërkuar që OE të paraqesë Certifikatë konformiteti dhe/ose Test raporte për to.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.